

URDHËR

“për vënien e sekuestros konservative”

Drejtuar: Qendra Kombëtare e Biznesit
Për dijeni: Shoqëria “Integrated Technology Services” sh.p.k, me Nipt L02302032C
Për dijeni: Shoqëria “One Explorer” sh.p.k, me Nipt L61307015S

Pranë Zyrës së Përmbartimit Gjyqësor Privat “AEF” sh.p.k. me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbartimore me palë:

Debitorit: Shoqëria “Integrated Technology Services” sh.p.k, me Nipt L02302032C
Kreditorit: Shoqëria “One Explorer” sh.p.k, me Nipt L61307015S
Objekti: Likujdim fature

Unë, Përmbartuese Gjyqësore Private Jonida Proga pasi shqyrtova materialin e dosjes përmbartimore,

KONSTATOVA:

Për titullin ekzekutiv Fatura tatimore e shitjes nr. 41/2021, datë 15.11.2021 për të cilin është lëshuar Urdhri i ekzekutimit nr. 363, datë 25.07.2023 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ka filluar procedura përmbartimore.

Pasi kanë kaluar afatet e parashikuara ligjore dhe debitori nuk e ka përmbushur detyrimin, në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile **nga ana e jonë është marrë vendimi i kalimit në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën** e sekuestros konservative në kuotat që zotëron pala debitore Shoqëria “Integrated Technology Services” sh.p.k, me Nipt L02302032C me qëllim mostjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar.

Për këtë arsye si dhe në bazë të nenit 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

URDHËROJ:

- Qendra Kombëtare e Biznesit të vendosë **masën** e sekuestros konservative në kuotat që zotëron pala debitore Shoqëria “Integrated Technology Services” sh.p.k, me Nipt L02302032C me qëllim mostjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar.
- Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.
- Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
- Ky urdhër mbahet në 4 kopje e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brënda 5 ditëve nga marrja dijeni.

Zyra e Përmbartimit Privat AEF shpk
Përmbartuese Gjyqësore Private
Jonida PROGA

